



Datë: 10.07.2025
Numër protokolli: 5049/2025

A.nr.894/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.894/2025, të datës 15.05.2025, të parashtruar nga ankuesi N.Q, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike-administrative, “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16, paragrafi, 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejaur ankesa me numër A.nr.894/2025, e datës 15.05.2025, e parashtruar nga ankuesi N.Q.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil N.Q (*referuar tutje vetëm ankuesja*), më datë 15.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit të vlerës prej 20% të pagës bazë si vëllim të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZHR), ndërsa, kjo e fundit, me datë 09.06.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3174/2025, të datës 15.05.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 06.03.2019; Vendimin Ref.ZSP-83123 i datës 21.08.2023; Vendimin Ref.ZSP-1261/23 i datës 29.11.2023; Vendimin Ref.ZSP-816/24 i datës 02.12.2024; Vendimin Ref.ZSP-186/2025 i datës 24.03.2025; Vendimin Ref.ZSP-118/24 i datës 08.02.2024; Emailin e datës 01.11.2024 nga B.S për H.A, A.O dhe A.G; Emailin e datës 01.11.2024 nga S.Sh për B.S; Emailin e datës 01.10.2024 nga B.S për S.Sh; Emailin e datës 14.11.2023 nga V.Ç për B.S; Emailin e datës 01.11.2023 nga F.G; Emailin e datës 14.01.2025 nga F.S për A.S dhe ankuesin; Emailin e datës 14.01.2025 nga M.R për F.R; Emailin e

datës 17.12.2004 nga F.R për ankuesin; Emailin e datës 16.12.2024 nga ankuesi për F.R; Emailin e datës 08.10.2024 nga F.S për ankuesin; Emailin e datës 27.11.2024 nga A.O për M.B; Kopjen e ID-së

së ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 09.06.2025; Listën e pagave shkuar 2023 për ankuesin; Marrëveshje për ndarjen e shërbimeve të një Çertififikues të vetëm e datës 08.02.2024; Marrëveshjen për punë me vëllim të shtuar e datës 08.02.2024; Listën e pagave shkurt 2024, janar 2024 për ankuesin; Formulari i pagesës retroaktive e datës 05.03.2024; Listën e pagave mars 2024 për ankuesin; Listën e pagave mars 2025 për ankuesin; Formular i pagesës retroaktive i datës 08.05.2025; Listën e pagave prill dhe maj 2025 për ankuesin; Listën e pagave dhjetor 2023 për ankuesin; Vendimin me numër protokolli 4380/2025 të datës 25.06.2025 për vazhdimin e afatit të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 06.03.2019, mbanë pozitën *Zyrtare i të Hyrave Financiare*, në MBPZHR. Tutje sipas shkresave të lëndës, rezulton së më Vendimin Ref.ZSP-83123, të datës 21.08.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR, ankuesi është caktuar përkohësisht zëvendësues i Zyrtarit Certifikues dhe Aprovues. Me tej, me Vendimin Re.ZSP-1261/23 të datës 29.11.2023 të u.d Sekretares së Përgjithshme të MBPZHR, ankuesi është caktuar ushtrues detyre i Zyrtarit Certifikues, ndërsa, më Vendimin Ref.ZSP-118/24 të datës 08.02.2024, të zv. Sekretares së Përgjithshme të MBPZHR, ankuesi është ngarkuar të kryej edhe punë shtesë të Zyrtarit Certifikues në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë për periudhën kohore 08.02.2024 deri 30.06.2024, dhe se për ushtrim të këtyre punëve shtesë, është lidhur edhe marrëveshje për vëllim të shtuar Nr. 01.2024 e datës 08.02.2024, në mes të ankuesit dhe

Referuar tuje shkresave të kësaj çështje del së më Vendimin Ref. ZSP-816/24, të datës 02.12.2024, të Sekretares së Përgjithshme të MBPZHR, ankuesit i është vazhduar mbajtja e pozitë ushtrues detyrës i Zyrtarit Certifikues dhe Aprovues deri në një vendim tjetër, kurse sipas Vendimit Ref.ZSP-186/2025 të datës 23.03.2025, është shfuqizuar Vendimit Ref.ZSP-816/24 i datës 02.12.2024 dhe Vendimi me Nr. 4474 i datës 03.12.2024, e ashtu që ankuesi është kthyer në pozitën sipas aktit të emërimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është kompensuar sipas rregulloreve në fuqi për periudhën nga data 22.08.2023 deri më datë 27.11.2024, në kohën kur përveç pozitës ushtrues detyre i Zyrtarit Certifikues dhe Aprovues në MBPZHR ka mbajtur edhe pozitën sipas akt emërimit Zyrtar i të Hyrave Financiare.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushemrisë së ankesës ju referua nenit 27, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar: “3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil”, si dhe nenit 124 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin parashihet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,..” dhe si rrjedhojë, nisur nga ky përcaktim ligjor, dhe duke u bazuar në administrimin e provave material të çështjes, Kolegji erdhi në konstatimin se ankuesi lidhur me realizmin e të drejtës në kompensim sikurse në ankesë, nuk ka parashtruar kërkesë të organi përkatës i punësimit, dhe për pasojë nuk kemi veprim apo mos veprim administrativ të organit të punësimit e që pretendohet se mund të ketë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme të ankuesit.

Rrjedhimisht, në kuptim të së drejtës së ankueses në mbrojtje juridike, Kolegji thekson faktin se ankuesi fillimisht duhet t'i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës së pretenduar, dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo kundër heshtjes së organit publik në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtroj ankesë në Këshill, duke respektuar afatet ligjore siç parashihen me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.894/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit N.Q;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MBPZHR; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*